



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Shkresë	01.04.2026
Nga:	ZPP Gentiana Qela 
PER:	Valdrini sh.p.k
Lenda :	VENDIM



Në pajtim me nenin 108/A, paragrafi 10, nën paragrafi 10.2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068 si dhe Ligjin 04/L-237 si dhe Ligjin nr. 05/L-092 si dhe Rregullores (A01) nr.001/dhe 002/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Valdrini sh.p.k të datës 30.03.2026 kundër njoftimit per dhenje për procedure të prokurimit me numër 611-25-9865-5-2-1 me titull “ Ndertimi i rrugës Kroni i Mbretit - Liqeni i Vasilevës,Drenas” dates 28.10.2025, Komuna e Drenasit (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit sjell:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik Valdrini sh.p.k. “të datës 30.03.2026 kundër njoftimit per dhenje të aktivitetit të prokurimit me numër 611-25-9865-5-2-1 me titull “ Ndertimi i rrugës Kroni i Mbretit - Liqeni i Vasilevës,Drenas” datës 28.10.2025
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdojë me njoftimin te AK të projektit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Valdrini sh.p.k .si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike e-prokurimi në adresën <http://e-prokurimi.rks-gov.net>
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues konform vendimit te Oshp ka sjelle lenden ne ri-vlersim dhe ka kerkuar sqarime sipas raportit te OSHP-se .

Ne sqarimet e prezentuara ju nuk keni permbushur kerkesat e Ak te paraqitura ne dosjen e tenderit .

Konstatojme se arsyjet e eliminimit jane komplet te qendrushme duke dhene sqarimet si me posht :

1. Për kriterin “Grejder me ripera dhe ndalesa të zhavorit, min. 16 ton – max. 18 ton”, është paraqitur marrëveshje me “Kthella” sh.p.k për një grejder me peshë 16 ton.

Megjithatë, në dokumentacion nuk është specifikuar nëse mjete posedon ripera dhe ndalesa të zhavorit, siç kërkohet në DT. Pra mungon në dokumentacion ose prova që vërteton përputhshmërinë me kërkesat e tenderit. ju keni paraqitur fotografi të cilat nuk dëshmojnë që qartë se Grejderi i ka të vendosura riperat dhe ndalesat dhe vetëm ato fotografi nuk dëshmojnë pa dokumentacion se i njëjti është sipas kërkesës në Dosje .

2. Në kuadër të kriterit për “Traktor 4x4 me lugë ngarkuese dhe lopatë rrafshuese”, është paraqitur marrëveshje me N.N. “Shkembali”, si dhe faturë ndërmjet N.N. “Shkembali” dhe “Vëllezërit Ramadani” për blerjen e një eskavatori–traktor. Nga dokumentacioni i dorëzuar nuk evidentohet se mjete është 4x4 me lugë ngarkuese dhe lopatë rrafshuese, siç kërkohet në DT. Sipas përshkrimit në faturë rezultojnë të jetë traktor i thjeshtë, ndërsa fotografia e bashkangjitur paraqet mjete Eskavator tip “Skip”, duke krijuar mospërputhje ndërmjet dokumentacionit dhe provave vizuale. Nuk është paraqitur dëshmia e pagesës për faturën gjithashtu nuk është paraqitur si traktor 4x4. Konstatohet se kriteri nuk është përmbushur në përputhje me DT dhe NJK.

3. Në kuadër të kriterit për pajisjen “Makinë për spërkatje të emulzionit (mobile)”, sipas marrëveshjes së paraqitur me kompaninë ABC, është dorëzuar një librezë e një kamioni special. Megjithatë, nga përmbajtja e librezës nuk evidentohet se në kamion është integruar sistemi apo pajisja për spërkatje të emulzionit.

4. Në të gjitha marrëveshjet e prezentuara nuk rezultojnë semaforët të jenë digjital por vetëm si semafor elektrik sipas specifikave të cekura në dosjen e tenderit .

Kunder këtij vendimi keni të drejtë ankese në OSHP në afatë prej 10 ditësh !

Me respekt !